

# PAGË BAZË PËR SECILIN QYTETAR

- Secili qytetar, pavarësisht përkatësive do ta ketë një bazë (60 euro) për ta krijuar e rritur jetën e tij këtu. Kjo Bazë është 300 euro për familjen mesatare në Kosovë.
- Skemat sociale ekzistuese mirëmbajnë pozitën ekonomike për pranuesit e tyre. Kushdo që pranon pagë, qoftë vetëm 1 herë, i ndërpritet mbështetja.
- Skemat sociale stigmatizojnë grupet e marginalizuara dhe përçajnë qytetarët midis tyre.
- Paga universale bazë heq nga varfëria çdo familje kosovare.
- 11 vende të botës tashmë e kanë pilotuar apo aplikuar

në një apo formë tjetër këtë program. 23 vende janë duke e diskutuar fillimin e zbatimit të pagës universale bazë.

- Efektet pozitive të Pagës Bazike Universale janë shumëdimensionale, që nga: përmirësimi i pagave, zhdukja e ciklit të varfërisë, ndërmarrësia, rritja e nivelit të lumturisë, përmirësimi i shëndetit, sidomos atij mendor.

Shteti është marrëveshje shoqërore ku llogaritet dhe përfshihet secili. Qytetarët midis vete nuk duhet t'i duhet t'i bashkojë veç letërnjoftimi.

Një jetë e mirë nuk reduktohet me shumën e transaksionit që e merr në formë page.



PSD  
PARTIA  
SOCIALDEMOKRATE

# FONDI I SIGURIMIT SOCIAL

PSD do të themelojë një institucion të veçantë të përkujdesjes shoqërore.

**Fondi i Sigurimit Social** do të bëhet mburojë për rreziqet që sjell presioni i tregut. Ky fond do të financohet 5% nga punëtorët dhe 5% nga punëdhënësit.

## Konteksti

Shkalla e papunësisë në Kosovë është 26%. Shteti nuk angazhohet për lidhje të tregut të punës me sistemin e edukimit. Papunësia në Kosovë është dyfish më e lartë se në Shqipëri ku është 11,9%.

79.2% e grave janë jo aktive në tregun e punës.

Aksidenti në punë apo edhe një sëmundje si kanceri ia rrezikon punëtorit dhe familjes së tij ekzistencën.

Një jetë e mirë nuk reduktohet me shumën e transaksionit që e merr në formë page.

Përditshmëria e një punëtori është ankthi i humbjes së punës dhe zhytja në varfëri; një sëmundje kronike për të vjen e dyfishuar sepse është edhe ndalim i të ardhurave. Një jetë e mirë kërkon një sërë të drejtash që do të ishin bazë për të ardhmen dhe siguri për çdo të papritur.

## Ndërhyrja

Çdo qytetar në rast të humbjes së punës do të kompensohet nga shteti.

- Shërbimet e punësimit do të reformohen rrënjësisht dhe volumi i punës do të rritet.
- Punëtori që humb vendin e punës do të kompenzohet me 80% të pagës për 6 muaj.
- Me qëllim të inkurajimit të punësimit të grave, PSD zotohet që pushimi i lehonisë mbulohet nga Fondi i Sigurimit Social, dhe jo nga punëmarrësi. Ai zgjatë 9 muaj. Prindërit mbështeten me 100% të pagës gjatë pushimit 2 javor. Pas dy javëve kompensimi është 500 euro në muaj, edhe për gratë e papuna.
- Pensioni invalidor në rast të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale do të jetë 100% i pensionit të moshës. Pensioni invalidor në rast të aksidentit apo sëmundjes jashtë vendit të punës është 50% i pensionit të moshës.
- 15 ditë pune të pushimit mjekësor brenda vitit i takojnë punëtorit sa 100% e rrogës. 3 muaj të tjerë sa 75% e rrogës, 1 vit pasues sa 50%, dhe më shumë se 1 vit 40%.

# TATIMI PROGRESIV DHE TAKSAT E MIRËQENIES

Tatimi progresiv është një nga instrumentet politike që përdoret për ta zvogëluar pabarazinë që e prodhon procesi akumulues i kapitalit. Hendeku që krijohet nga procesi akumulues merr formën e konfliktit shoqëror sa herë që shteti qëndron pasiv karshi kësaj dukurie. Emigracioni është po ashtu një formë e reagimit karshi pabarazisë.

Indikatorët e EUROSTAT, qoftë shikuar nga të ardhurat e disponueshme, qoftë hendekun midis shtresave, tregojnë që niveli i pabarazisë në Kosovë është më i larti në Evropë.

Kosova është sui generis sepse është parajsë për të pasurit dhe ferr për të varfrit. Vetëm këtu nuk ka fare tatim në dividendë dhe tatim në trashëgimi. Aty ku ekziston tatimi, ai është i sheshtë, pra pa konsideratë për grupet shoqërore që dallojnë për nga të ardhurat dhe pozita e tyre në shoqëri.

**PSD përmes angazhimit të saj politik-programor prezanton një sistem të ri tatimor:**

**TAKSAT E MIRËQENIES** janë taksat e reja që do t'i shtohen sistemit tonë tatimor, bashkë me rishikimin e tatimit në korporata. Ato janë:

1. Tatimi në Dividentë;
2. Tatimi në Trashëgimi;
3. Tatimi në të Ardhurat e Korporatave.

## Tatimi në dividendë

Dividenda është fitimi i nxjerrur nga qarkullimi ekonomik pas përfundimit të xhiros vjetore. Pasi kryhen investimet, pagat dhe të gjitha shpenzimet e tjera të kostos, mbetet dividenda - fitimi i pastër i pronarit që del nga ekonomia dhe kryesisht shkon jashtë vendit dhe në shpenzime luks.

Tatimi në dividendë sipas programit tonë do të jetë 33%.

## Tatimi në trashëgimi

Trashëgimia është mal me mundësi për dikë, dhe gropë e thellë e pamundës së për dikë tjetër. Ajo e pamundëson mobilitetin social, shtresat e klasat i bën kasta.

Ndryshe nga vendet gjithandëj botës, në Kosovë nuk paguan taksë në trashëgimi askush. Vit pas viti, gjeneratë pas gjeneratë, familjet e pasura mbeten të pasura, të varfërat nuk e kanë as shansin. Hendeku mes atyre që kanë pronë dhe atyre pa pronë duhet të zvogëlohet.

Fati yt nuk duhet të jetë prejardhja,

por ekzistenca bashkë me të tjerët si pjesë e një kontrate shoqërore.

## Propozimi i PSD-së për Tatimin mbi Trashëgiminë

SHKALLËT	NORMA VLERA QË	TATIMI
TATOHET		
€ 25,000	0%	€ 25,000 € -
€ 75,000	8%	€ 50,000 € 4,000
€ 125,000	14%	€ 50,000 € 7,000
€ 175,000	20%	€ 50,000 € 10,000
€ 225,000	26%	€ 50,000 € 13,000
€ 275,000	32%	€ 50,000 € 16,000
€ 325,000	38%	€ 50,000 € 19,000
€ 375,000>	44%	€ €

## Tatimi në të Ardhurat e Korporatave

Rritja e ndjeshme e kësaj forme tatimore përmbyll taksat e mirëqenies.

Tatimi në të ardhurat e korporatave në Kosovë është ndër më të ulët në Evropë. Vetëm 4% e buxhetit kombëtar sot mbushet nga ky tatim.

Sipas rregullimit aktual, ata që përfitojnë më shumë nuk i kthejnë asgjë shoqërisë. Kjo do të ndryshojë!

Tatimi në të Ardhurat e Korporatave, nga 10% sa është aktualisht, do të bëhet 23%.

Biznesit të vogël dhe të mesëm nuk do t'i ndryshohet norma

tatimore.

## Tatimi në të Ardhurat Personale

Tatimi në të Ardhura sot është i sheshtë. Për pjesën e pagës që kalon 450 euro paguajnë 10%, njëjtë sikur mësuesi, ashtu edhe drejtori i një banke.

Me skemën tonë, rreth 80% e të punësuarve do të paguajnë më pak tatim. Më pak do të paguajnë të gjithë ata që kanë pagë bruto deri në 750 euro.

Të punësuarit me pagë më të lartë se 750 euro do të paguajnë më shumë tatim në pagë.

Paga minimale do të jetë 300 euro. Ai që merr pagë 300 euro nuk duhet të ngarkohet në kontribute. Shumat mbi 300 euro do të fillojnë të taten në mënyrë progresive në mënyrë që ata që përfitojnë më shumë të paguajnë më shumë.

## Propozimi i PSD-së për Tatimin mbi të Ardhurat Personale

0€ - 300€	0%
300€ - 450€	4%
450€ - 600€	10%
600€ - 750€	20%
750€ - 900€	24%
900€ - 1700€	28%
1700€	32%

# B A Z E



**PSD**  
**PARTIA**  
**SOCIALDEMOKRATE**

## ZHVILLIMI I HERSHËM I FËMIJËVE

### Konteksti

Në Kosovë janë vetëm 49 çerdhe publike. Shumica dërrmuese e çerdheve janë private. Vetëm 6.2% e fëmijëve të grupmoshës 0-5 vjeç shkojnë në çerdhe. Në Shqipëri kjo shifër është 80%. Në Evropë 94%.

Ka tashmë pajtueshmëri mbi dobitë që përfiton shoqëria dhe anëtarët e saj që janë bërë pjesë e edukimit të hershëm. Studimet flasin se fëmijët që kanë ndjekur edukimin e hershëm kanë zhvillim gjuhësor, shoqërizim më të mirë, e aftësi më të mira njohëse.

Nga kjo situatë, me tërë këto mungesa, në Kosovë kanë përfituar veprimtaritë private. Për më tepër kanë vazhduar të ruhen rolet tradicionale në familje.

Prandaj, çerdhja është edhe

ndërhyrje e domosdoshme, edhe shpenzim i vlefshëm për të ardhmen e shoqërisë.

### Ndërhyrja

Që ndërhyrja të jetë e ndjeshme, duhet që:

- Të ndërtohen së paku 700 çerdhe. Përfshirja e fëmijëve në çerdhe duhet të jetë masive.
- Edukimi dhe kujdesi i hershëm parashkollor duhet të jepet për të gjithë fëmijët e Kosovës, pa përjashtim.
- Investimet infrastrukturore në ndërtimin e çerdheve janë të mundshme. Përmes borxhit publik ose kapaciteteve vetanake, këto investime janë të sigurta dhe të provuara si të dobishme.

Vetëm 6.2% e fëmijëve të grupmoshës 0-5 vjeç shkojnë në çerdhe. Në Shqipëri kjo shifër është 80%. Në Evropë 94%.

## SHËNDETËSI PUBLIKE

### Konteksti

Shëndeti i qytetarit nuk ka qenë asnjëherë prioritet i qeverisjes. Shëndetësia publike përveç që gërryhet nga brenda prej formave privatizuese, ajo e ka mbi kokë edhe presionin e emigrimit.

Shërbimet janë komercializuar përmes mënyrave formale e joformale.

Marrëdhënia korruptive midis sektorit publik dhe atij privat e ka si vaj lëvizës profitin drejt spitaleve private. Xhepat e zbrazur të qytetarëve janë pasojë direkte e kësaj marrëdhënie, kurse shëndetësia publike e shtrirë përtokë është mbetja kolaterale e krejt këtij procesi.

Mjekët tanë përfundojnë shkollimin nga shpenzimet e buxhetit publik të vendit, për t'i punësuar Gjermania me zero kosto. Në vitet e fundit nga Kosova janë larguar 11% e specialistëve mjekësor. Kosova e varfër është praktikisht sponsore e shëndetësisë gjermane.

Modeli i sigurimeve shëndetësore nuk i përshtatet kushteve të Kosovës. Ky model mbulon vetëm ata që kanë kontrata pune. Shumë të papunë dhe punëtorë pa kontratë mbeten pa u mbuluar.

### Ndërhyrja

- Shëndetësia, sa më private, aq më e kushtueshme, prandaj duhet një sistem shëndetësor publik për të gjithë. Komercializimi e dehumanizon shëndetësinë. Shëndetësia në

Kosovë do të jetë e organizuar në atë mënyrë që financimi të bëhet nga taksat, infrastruktura publike, kurse qasja të garantohet për të gjithë sepse buron nga nënshtetësia.

- 300 milionë euro financim në ndërtim dhe përmirësim të infrastrukturës, rritje të personelit dhe nivelit të pagave në sistemin shëndetësor. Paga e mjekut dhe infermierit duhet të rriten ndjeshëm.
- Shpenzimet për barëra, të cilat kalojnë shumën prej 300 euro brenda vitit, do të mbulojnë nga shteti. Nga kjo përfitojnë në veçanti personat që trajtohen me sëmundje më të rënda që kanë shpenzime më të mëdha të terapisë.
- Pas rritjes së ndjeshme të financimit dhe ndërhyrjeve transformuese, kapacitetet do të rriten e infrastruktura do të zgjerohet. Kështu, për 3 vjet shëndetësia publike do të arrijë nivele tjera. Pas 3 vitesh fazë kaluese, shërbimet që i ofron sektori publik nuk do të mund t'i japë sektori privat.
- Shërbime private do të ketë vetëm në fushën estetike.

Në vitet e fundit,  
**11%**  
e mjekëve specialistë janë larguar nga Kosova